

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 9 MAJ 2022

Të dashur qytetarë e qytetare, që ndiqni këtë seancë,

Zonja e zotërinj deputetë,

Zonja kryesuese e seancës,

Në Ditën e Europës shfrytëzoj rastin për të shprehur mirënjohjen më të pakufishme në lidhje me solidaritetin dhe ndihmën e jashtëzakonshme që Bashkimi European dhe vendet anëtare i kanë dhënë gjatë Shqipërisë këtyre dekadave, ndihmë e cila, në hapat e parë të pluralizmit mund të them se ka qenë shpëtimtare për shoqërinë tonë. Sot integrimi i Shqipërisë është shndërruar në një horizont që largohet çdo ditë e më shumë, kjo jo për shkak të Europës, por kryekëput për shkak të shndërrimit të Shqipërisë në kanabistan, në vendin më të korruptuar të Europës dhe një prej vendeve më të korruptuara të planetit, në vendin ku dhunohen liritë dhe të drejtat njerëzore themelore, në vendin ku drejtësia vendoset tërësisht nën kontrollin e ekzekutivit, ku mediet janë nën një censurë të rreptë dhe në tërësi liritë e të drejtat nëpërkëmben çdo ditë nga një regjim që ka zëvendësuar shtetin ligjor me narkoshtetin. Zonja dhe zotërinj, Unë jam këtu, gjithashtu, për të dënuar edhe një herë me forcën më të madhe vdekjet në qelitë e zeza të komisarivateve dhe burgjeve në Shqipëri, të cilat, de facto, janë shndërruar në birucat e dikurshme të Sigurimit të Shtetit. Në një hark kohor 5-javor në Kamzë dhe në Kavajë humbin jetën, vriten apo vetëvriten dy të rinj në qeli, në vendin, ku sipas ligjit, duhet të ishte më i sigurti. Duke e dënuar me ashpërsinë më të madhe qeverinë e këtij regjimi ndaj këtyre rasteve, vrasje të mirëfillta shtetërore, ju ftoj, të nderuar deputetë, të nderojmë me një minutë heshtje të gjithë ata që vdiqën në qelitë e narkoregjimit shqiptar! Qoftë i paharruar kujtimi i viktimave të shtetit në burgjet e tij!

Zonja dhe zotërinj, Sot mediet informojnë se shqiptarët blejnë ushqimet e tyre mesatarisht 20% më shtrenjtë se një muaj më parë. Rritja stratosferike e çmimit të ushqimeve ka bërë që sirenat e urisë të oshëtijnë në të katërt anët e vendit. Rritja stratosferike e çmimit të ushqimeve ka bërë që dhjetëra të sëmurë të mos blejnë dot ilaçet e tyre. Narkoqeveria rri duarkryq, mjaftohet me propagandë dhe deklarata, ka krijuar borde, të cilat, në fakt, janë shushunja po kaq të tmerrshme sa monopolet. U bëj thirrje anëtarëve të bordeve të japin urgjentisht dorëheqjen dhe të mos përlligjin këtë vjedhje të tmerrshme që u bëhet qytetarëve shqiptarë nga monopolistët e qeverisë. Inflacioni dhe rritja e çmimeve kudo në botën e lirë ka një përgjigje: indeksimin, indeksimin dhe indeksimin, ndërsa me borde vetëm përlligj spekulimin, spekulimin dhe spekulimin. Duhet të marrë fund kjo praktikë e shushunjave. Bordet i kanë blerë me lecka monopolet. Qytetarët varfërohen, qeveritarët dhe bordet e tyre pasurohen, oligarkët pasurohen. Zonja dhe zotërinj, Besimtarëve myslimanë shqiptarë Edi Rama ua prishi gëzimin e Bajramit. Ai nuk e hapi xhaminë dhe jo vetëm kaq, por informohem se ai ka dërguar njerëz për t'i bërë presion kryetarit të Komunitetit Mysliman të japë dorëheqjen, sepse, sipas tij, këtë e kërkon Presidenti i Turqisë, Erdogani. Unë jam këtu për t'i dënuar me forcën më të madhe këto qëndrime të Edi Ramës. Nuk lejohet asnjë ndërhyrje në autonominë e komuniteteve fetare. I bëj thirrje

Presidentit të Turqisë të sjellë çdo dosje për çdo individ, por të fajësojë njerëz, të fajësojë qytetarë fetarë apo zyrtarë pse janë shkolluar me fondet e Gylenit, kur ai ka qenë aleati i tij më i ngushtë, kjo nuk mund të ndodhë. Me gjithë respektin që kam për vendin tuaj dhe ju, zoti President, kjo nuk mund të ndodhë. Kjo nuk është, absolutisht, e drejtë dhe është e paimagjinueshme që të ndërhyhet se kush duhet të jetë kryetar i Komunitetit Mysliman.

Gjithashtu, jam këtu me një mesazh të qartë: ne ju falënderojmë për ndërtimin e xhamisë, por kur nesër Partia Demokratike të jetë në pushtet, ajo do të paguajë çdo qindarkë të harxhuar për ndërtimin e xhamisë. Për ne autonomia e komuniteteve fetare është më e çmuar se shumë e shumë ndërtesa kulti. Edhe një herë, e dënoj qëndrimin e Edi Ramës, si dhe kërkoj një komision urgjent hetimor parlamentar për dëshminë publike të prokurorit Arjan Ndoja, i cili thotë se e kam të regjistruar Kryeministrin, duke diskutuar me banda dhe banditë. Unë jam njeriu që e kam sulmuar vetë Arjan Ndojan dhe kjo dihet, nuk është sekret, por problemi është që mbi Arjan Ndojan u shkrehën bateri kallashnikovi dhe unë nuk jam kurrë dakord që të vriten njerëz. Pikërisht në momentin kur Arjan Ndoja ishte nën breshëritë e kallashnikovit, Edi Rama, në mënyrë të çuditshme, lëshonte breshëri kundër tij, vetëm sa nuk thoshte: "Sa keq që shpëtove". Pra, a kishte gisht Edi Rama prapa atij atentati? Kjo do hetim. Çfarë ka pasur në tabulatet që prokurori Ndoja e denoncon me guxim? Kjo do hetim dhe nuk e mbron dot njeri Edi Ramën nga këto.

Dua t'ju them se nuk janë vetëm këto tabulate që e komprometojnë Edi Ramën dhe ministrat e tij, telefoni i famshëm BQ, është në analizë dhe po analizohen zërat për të dalluar se të kujt janë, po zbardhen mesazhet e tyre...